

D E K R E T
Nr.1579, datë 13.8.1996

PËR NDËRTIMIN E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 28, pika 19, të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”,

D E K R E T O J:

Neni 1

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i Republikës së Shqipërisë është organ përhershëm, i cili organizon, drejton dhe kontrollon zhvillimin e zgjedhjeve në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me dispozitat ligjore elektorale të shtetit shqiptar.

Në përputhje me dispozitat e ligjit nr.7556, datë 4.2.1992 “Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr.8055, datë 1.2.1996, si dhe me dispozitat e ligjit nr.7573, datë 16.6.1992 “Për zgjedhjet e organeve të pushtetit lokal”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve caktohet nga Presidenti i Republikës dhe përbëhet nga kryetari, zëvendëskryetari, sekretari dhe 14 anëtarë.

Neni 2

Propozimet për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve i dërgohen Presidentit të Republikës nga Këshilli i Ministrave dhe partitë politike.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve e ushtron veprimtarinë e tij për një periudhë 7- vjeçare. Anëtarët e tij gëzojnë të drejtën e riemërimit.

Neni 3

Për kryesinë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve propozimet bëhen nga Këshilli i Ministrave, nga rradhët e personelit shkencor universitar. Sekretar i Komisionit është drejtuesi i drejtorisë së organizimit të zgjedhjeve dhe referendumeve në Sekretariatën e Shtetit për Pushtetin Lokal.

Vendet e anëtarëve të Komisionit ndahen në mënyrë të barabartë midis partive politike pjesëtare të koalicionit qeveritar dhe të opozitës. Brenda këtyre ndarjeve, vendet në Komision zihen nga përfaqësuesit e partive politike në përpjesëtim me rezultatet e arritura prej tyre në zgjedhjet për organet e pushtetit lokal.

Neni 4

Në rast se partia politike që bën pjesë në grupin e koalicionit qeveritar ose të opozitës, largohet nga ky grup, atëherë edhe vendi ose vendet që i takojnë asaj në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve rishpërndahen brenda grupimit përkatës në përputhje me kriterin e vendosur në paragrafin 2 të nenit 3. Në rast se kjo parti ka arritur rezultate më të larta në zgjedhjet për organet e pushtetit lokal sesa ndonjëra nga partitë e grupit në të cilin ajo hyn dhe që kanë përfaqësues në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, atëherë partisë që largohet nga grupimi përkatës i garantohet vendi i anëtarit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, që i përket partisë që ka arritur rezultate më të ulta në këto zgjedhje.

Pas përfundimit të zgjedhjeve për organet e pushtetit lokal, raportet e përfaqësimit të partive politike në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndryshojnë në përputhje me rezultatet e arritura prej tyre në këto zgjedhje.

Ndryshimet në përbërjen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nuk mund të bëhen në 15 ditët e fundit përpara fillimit të zgjedhjeve.

Neni 5

Kur partia politike, të cilës i takojnë vende në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, nuk paraqet kandidatura për zënien e këtyre vendeve, atëherë vendet e caktuara për të zihen nga kandidatët e propozuar nga partitë e tjera politike sipas rradhës së përcaktuar në bazë të kritereve të paragrafit 2 të nenit 3, jo më vonë se 15 ditë para ditës së zgjedhjeve.

Neni 6

Në nenin 35 të ligjit nr.7556, datë 4.2.1992 “Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr. 8055, datë 1.2.1996, bëhen këto ndryshime:

1. Në paragrafin e dytë hiqen fjalët “ ... që kanë paraqitur lista elektorale për ndarjen e mandateve shtesë, jo më vonë se 45 ditë përpara ditës së zgjedhjeve.”

2. Paragrafi i tretë ndryshohet si vijon: “Partitë politike që nuk kanë anëtarë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve kanë të drejtë të dërgojnë vëzhgues pranë tij, që nga data e fillimit të fushatës së zgjedhjeve e deri në përfundim të tyre.”

Neni 7

Në fjalinë e parë të nenit 46 të ligjit nr.7556, datë 4.2.1992 “Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr.8055, datë 1.2.1996, hiqen fjalët “... në Komisionin Qendror apo ...”.

Neni 8

Në nenin 29 të ligjit nr.7573, datë 16.6.1992 “Për zgjedhjet e organeve të pushtetit lokal” bëhen këto ndryshime :

1. Në paragrafin e dytë hiqen fjalët: “ ... jo më vonë se 30 ditë para ditës së zgjedhjeve.”

2. Paragrafi i tretë ndryshohet si vijon :

“Partitë politike që nuk kanë anëtarë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve kanë të drejtë të dërgojnë vëzhgues pranë tij, që nga data e fillimit të fushatës së zgjedhjeve e deri në përfundim të tyre.”

Neni 9

Në paragrafin 1 të nenit 36 të ligjit nr.7573, datë 16.6.1992 “Për zgjedhjet e organeve të pushtetit lokal” hiqen fjalët “... në Komisionin Qendror apo ...”.

Neni 10

Dekreti nr.1568, datë 2.8.1996 “Për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve të Republikës së Shqipërisë”, shfuqizohet.

Neni 11

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

KUNDËRFIRMOHET
KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

PRESIDENTI I REPUBLIKËS

Sali Berisha